



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 13, date 10/03/2004

PËR

**“MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE NIVELIT TË PAGAVE
TË DREJTORISË NR.2 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT”.**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/200 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma ç, ligjit Nr.8487, dt. 13/05/1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, ndryshuar me ligjin 8935, dt.12/09/2002 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.8487, dt. 13/05/1999”, neni 3, gërma d, VKM Nr.551, dt. 7/11/2002 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page, përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, pika 14 dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.21, dt. 13/02/2001 “Për miratimin e krijimit të Ndërmarrjes Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit”, ndryshuar me Vendimin Nr.42, dt.27/04/2002, Vendimin Nr.4, dt.11/02/2002, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Ndryshimin e strukturës organizative të Ndërmarrjes Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit, të përcaktuar në pikën 3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.21, dt.13/02/2001 “Për miratimin e krijimit të Ndërmarrjes Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit”, si më poshtë;
 - 1) Transformimin e Sektorit të Prodhimit të Asfalto-Betonit, Repartit të Frantosë dhe Pllakave Bituminoze, nga gjysëm buxhetore (me vetëfinancim) në strukture buxhetore.
 - 2) Ndërmarrja Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit të quhet Drejtoria Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit.
 - 3) Shkëputjen e Sektorit të DDD-së dhe Sektorit të Vendstrehimeve dhe transferimin e tyre, si pjesë e një strukture tjetër të varësisë së Bashkisë Tiranë.

2. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi, miratohet struktura organizative sipas organigramës bashkëlidhur dhe numri i punonjësve (191 punonjës) të Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit.
3. Miratimin e nivelit të pagave të Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit, sipas lidhjes Nr.3 bashkëngjitur.
4. Zbatimi i pikës 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, përfshirë edhe efektet financiare të tyre, do të fillojnë në dt.01/04/2004 dhe do të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2004.
5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 27, dt.03/03/2000 “Mbi kalimin e Sektorit të Prodhimit të Asfalto-Betonit, Repartit të Frantosë dhe Pllakave Bituminoze, të Ndërmarrjes Komunale të Rrugëve nga sektor buxhetor në gjysëm buxhetor me vetëfinancim shfuqizohet.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Pergjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI